



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 23.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë dhe nenet 14, 16 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr;

### VENDIM PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

#### Neni 1

Vëhet në konsultim publik Draft Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Podujevës 2026-2028

#### Neni 2

*Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 30 ditë përkatësisht prej datës, 10.03.2026 deri më 10.04.2026, brenda së cilës Grupi Punues për hartimin e Draft Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Podujevës 2026-2028, mund të organizoj diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse Debatit i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më 07.04.2026, duke filluar nga ora 10:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve.*

#### Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit/konsultimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; [liman.zeqiri@rks-gov.net](mailto:liman.zeqiri@rks-gov.net) të cilat pastaj përcjellën në Zyrën përkatëse, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

#### Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik) dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Komuna e vlerëson të nevojshme.

#### Neni 5

Konsultimi/debati publik zbatohet nga Grupi Punues për hartimin e Draft Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Podujevës 2026-2028, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga konsultimi dhe debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

#### Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 02-016/01-00 11618126  
Podujevë, datë; 02.25.02.2026

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi

